

LULJETA MINE,
ARJAN SHUMELI

KONTRIBUTI I ILIA MITRUSHIT NË TERMINOLOGJINË E PYLLTARISË

1. Hyrje

Mitrushi lindi në Panarit të Korçës më 1904, ku dhe kreu shkollën fillore me rezultate të shkëlqyera. Shkollën e mesme dhe studimet e larta i kreu në Austri. Në 1950, inxhinier Mitrushi emërohet në Institutin e Shkencave. Ai i përkushtohet kërkimit shkencor në fushën e pyjeve dhe më 1955 fiton titullin “Bashkëpunëtor shkencor”. Gjatë kësaj kohe boton shumë artikuj shkencorë në *Buletin e Shkencave* dhe kulmin e arrin me veprën monumentale “Drurët e shkurret e Shqipërisë”, e para e këtij lloji në vendin tonë. Në këtë botim prej 600 faqesh janë përshkruar rreth 330 lloje drurësh dhe shkurresh. Punë të vyer bëri Mitrushi në përcaktimin për herë të parë të zonave fitoklimatike të Shqipërisë. Drejtim mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë së tij është përcaktimi i terminologjisë shqipe të dendro-florës. Për këtë punë të mirëfilltë shkencore ai harxhoi mbi 20 vjet, sistemoi mbi 4500 skeda dhe arriti të shkruante mbi 5000 faqe material shkencor. Veprimtaria e tij shkencore njihet dhe vlerësohet brenda dhe jashtë vendit. Ai ishte bashkautor në përpilimin e veprës “Flora evropiane” me qendër në Kembrixh, si edhe i veprës “Atlasi i Florës së Evropës”, Helsinki, 1979.

2. Vepra “Drurët e Shkurret e Shqipërisë”, pjesë e terminologjisë së pylltarisë

Vlerat leksikore krahas atyre shkencore që mbart vepra “*Drurët e Shkurret e Shqipërisë*” na kanë nxitur që të ndërmarrim këtë punim duke shfrytëzuar lëndën gjuhësore të përfshirë në të.

Prof. Mitrushi punoi me një përkushtim të madh për mbledhjen e fjalës shqipe, fjalëve dialektore, duke i mbledhur me kujdes në të gjitha krahinat dhe viset e banuara nga shqiptarët, duke i ngritur ato në statusin e termave dhe duke i futur në terminologjinë e pylltarisë. Në fakt, terminologjia merr çdo fjalë nga burime të ndryshme që i duhen për të plotësuar sistemin e saj, dhe në të vërtetë ajo sjell pasurimin e saj nga këto fjalë.

“Një burim për terminologjinë ka qenë gjuha e popullit, ndaj janë marrë shumë fjalë e janë bërë terma” Me të drejtë Prof. Mahir Domi

theksonte se “në ekskursionet e tij të ndryshme në gjithë anët e Shqipërisë, ai mblodhi shumë njësi leksikore të kësaj fushe (botanikës), të përcaktuara saktë nga ana shkencore, duke u shënuar çdo herë vendin ku është dëgjuar fjala”

Në veprën “Drurët dhe shkurret e Shqipërisë” gjithashtu gjen të mishëruar qartazi mendimin e Sami Frashërit “se fjalët e të gjitha dialekteve e të folmeve duhen vlerësuar si pasuri e përbashkët e shqipes”. Vërtet mund të thuhet se ai është unik, i papërsëritshëm me kontributin e tij në terminologjinë e pylltarisë për disa arsye:

Së pari, ai solli një pasuri të paçmueshme lënde leksikore prej të dy dialekteve.

Së dyti, kjo lëndë leksikore me karakter dialektor plotësoi mungesat e terminologjisë së pylltarisë duke e pasuruar më tej atë.

Së treti, Mitrushi me veprimtarinë e tij ka shërbyer jo vetëm si mbledhës i mirë i fjalës së popullit, por është dhe një nga burimet kryesore dhe gur themeltar në hartimin e fjalorëve terminologjikë, teksteve universitare, manuale, në shkrimin e artikujve shkencorë lidhur me pylltarinë etj.

Së katërti, ai është një autor që solli koncepte të reja në pylltarinë shqiptare falë studimeve të kryera jashtë shtetit dhe punës së tij të palodhur.

Leksiku i pasur, i përdorur prej tij është treguesi që shpreh qartë pasurinë gjuhësore të Mitrushit, që tregon se ai e njeh mirë gjuhën shqipe dhe potencialet e saj dhe nuk ngurron t’i përdorë ato në funksion të terminologjisë së pylltarisë.

Materiali gjuhësor i cili krijon shtresime krahinore, të përdorura në mënyrë funksionale, i kapërcen kufijtë e të qenurit dialektor, që me të drejtë mund të thuhet se përveçse gjuhë krahinore, është dhe gjuhë kombëtare.

Krijimi dhe vjelja e një korpusit të tillë fjalësh ka ndihmuar punën e specialistëve të pyjeve, por edhe të terminologëve. Një nga kolegët e tij e përshkruan se “ai ishte fjala e fundit shkencore në identifikimin e përcaktimin e bimëve”. Shumë prej termave të tij janë shfrytëzuar në Fjalorin e emrave të bimëve” (2003) nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe ajo e Kosovës, në “Frytet dhe farat e drurëve dhe shkurreve të Shqipërisë”, si dhe në tekste universitare etj.

Mitrushi la një pasuri terminologjike të admirueshme për periudhën së cilës i përket si edhe hapi rrugën për hartimin e fjalorëve terminologjikë, për fushën e bujqësisë e të pylltarisë.

3. Leksiku terminologjik i veprës

Prof. Mitrushi ishte inxhinier pyjesh. Krahas punës së tij si inxhinier, ai zhvilloi një veprimtari si gjuhëtar, si studiues i fjalës shqipe duke e pasuruar më tej leksikun e terminologjisë së pylltarisë dhe duke lënë pas një pasuri për brezat e ardhshëm.

Krahas rëndësisë që ka për informacionin tekniko-shkencor që vepra “Drurët dhe shkurret e Shqipërisë” përcjell, nuk mund të lëmë pa përmendur meritën e madhe për ndihmesën që autori dha në krijimin e një pjese të terminologjisë së pylltarisë duke shfrytëzuar gurrën popullore. “Të shpejtosh në mbledhjen e kësaj pasurie do të thotë ta shpëtosh atë nga humbja”. Është kjo arsyeja që Prof. Jani Thomai e konsideron “gjurmimin, mbledhjen e studimin e fjalës shqipe si një detyrë jo vetëm shkencore, por edhe atdhetare”. Puna e tij tepër përkushtuese në këtë vepër të vyer na shërben që të zbulojmë autoktoninë e gjuhës sonë dhe të terminologjisë së pylltarisë në veçanti.

Vepra “Drurët e shkurret e Shqipërisë” dallohet për një nivel të lartë terminologjik, gjuhësor dhe profesional, ku është realizuar një ndërthurje e leksikut popullor me leksikun terminologjik.

Një vend të veçantë në këtë vepër zë emërtimi i llojeve të ndryshme bimore dhe drunore me fjalë të vjela nga gurra popullore për një kohë të gjatë, duke i shndërruar ato në terma, ku konceptet që ato shënojnë futen në sistemin e fushës së pylltarisë si elemente përbërëse të pjesëve të bimëve, drurëve etj. Vlen të përmendet fakti se të dy dialektet zënë të njëjtin vend, që do të thotë se në fjalësin leksikor të veprës janë përdorur fjalë të të gjithë truallit gjuhësor të shqipes.

Këto fjalë ai i ka shoqëruar me shënimin përkatës të krahinës nga e cila është vjelë, p.sh. (po i sjellim siç i ka shkruajtur autori), **vadhëviçja e bardhë** – *ftua i egër, lulubardh* (Hormovë, Përmet), *mollëzviçezë* (Dajt, Tiranë), *vodhëveç* (Mat), *vodhëviçe* (Shpat), *vodhëviçe* (Këthellë), *vollëviçe* (Pukë), *zokth* (Malësi e Madhe); **gjunjëza kërcilakëse** – *bar guri, bar ngjitës, bar varës* (Vuno, Himarë), *dredhëzë shkëmbi* (Radhimë, Vlorë), *gjunjëzë* (Shkozë, Kudhës), *qirith* (Qeparo); **pisha e zezë-ble** (Culli, Krujë), *borigë* (Korçë), *çetinë* (Malësi e Madhe), *gëdha* (gegërisht), *gëdhe, gdhe, gëve, gve* (Mirditë), *halë* (Mat, Mirditë, Pukë), *pishë* (shumkund), *kreshtë* (Dibër), *Pishak* (Fugovë, Pejë), *vgje-ni* (Shpat), *vgjeri* (Vërçë), *vgjer-i* (Bërzështë, Mokër); **selvija** – *çipras* (Shkodër), *selvi* (kudo), *qiparis* (toskërisht); **dëllinja e zezë** – *dëllenjë* (shqiptarët e Greqisë), *dëllenjë* (Kurveleshi), *dëlli, dulli* (gegërisht), *dëllinjë* (Berat, Kolonjë), *dëllinjë e egër* (Divjakë, Myzeqe), *dëllinjë e zezë* (Korçë),

dullajë (Kosovë), *dullenjë e egër* (Ternovë, Zerqan); ***bredh*** (termi standard) *bre*, *bredh* (Shqipëria e Veriut), *breth* (toskërisht), *bren-i* (Gostivar), *mbreth* (zona e Shpatit) etj.

Ekzistenca e njësisë sinonimike midis fjalëve të shumta të dialekteve tregon lidhjet e tyre të forta në brendësi të gjuhës shqipe duke e pasuruar më shumë atë. “Kjo lëndë e mbledhur në gjirin e popullit dhe ajo që do mblidhet, ka ushqyer e do të ushqejë jo vetëm fjalorët e shqipes (shpjegues, terminologjikë) të hartuar deri tani dhe atyre që do të hartohen në të ardhmen, por edhe studimet gjuhësore shqiptare”. Ndaj, kjo vepër sjell një pasuri leksikore për terminologjinë e pylltarisë. Është një punë vetjake, një lëndë e nxjerrë nga vetë autori i cili ka shfrytëzuar më së miri trashëgiminë leksikore të shqipes.

Shumë terma shoqërohen jo vetëm me ilustrime e figura, por me shpjegime përkatëse, në mënyrë që ato të lidhen me realien, të identifikohen lehtësisht nga studentë edhe specialistë të fushës në fjalë, p.sh.: ***degë*** – quhen trungjet sekondarë më të trashë dhe më të moçëm të kurorës; ***degëza*** – quhen degët sekondare më të holla dhe më të reja të kurorës; ***gjethe heshtake*** – kur janë më shumë më të gjata se të gjera, por në trajtë heshte, d.m.th. me gjerësinë më të madhe në një të tretën e tyre, të llogaritur prej fundit; ***gjethe e rëpuqtë*** – kur nuk ka push ose qimëza; rrëmba – dejet më të imta të një gjetheje, që lidhin dejet anësore mes tyre ose dellin kryesor me dejet anësore etj.

Ai ka krijuar ***njësi të qëndrueshme togfjalësore***, si: gjethe e gishtuar, gjethe e rëpuqtë; mëllugë me dhëmbë të vegjël; rreshtimi i gjetheve; dejësi e gjetheve; renditje tjegullore; njollë gjethe; gjethe të kundrejtuar; gjethe të këmbëra; gjethe të pupluara; grashina pranverore pyjore etj.

Po të hedhim një vështrim të kujdesshëm, do të shohim se kjo vepër përbën një nga pjesët përbërëse të fjalësit tërësor të terminologjisë së pylltarisë, si edhe do të zbulonim një fond autokton të shqipes.

Duke patur si bazë brumin e gjuhës shqipe dhe duke u përpjekur që të sjellë sa më shumë terma shqip, në këtë vepër na shfaqet ***sinonimia***, si p.sh. *lëvore* – *zhapë* (15); *thimth* – *majë*; *llapa e gjethe* – *llamina*; *burbuqe* – *syth lulesh*; *mëlluga* – *luspa*; *korkë* – *kore*; *tevluku* – *kulari*; *nervaturë* – *dejësi*; *halore* – *acikulare*; *ovale* – *vezore*; *stipulat* – *gjethe të rrëgjua*; *zhguall* – *zhgonjë*; *gathi* – *rezhda* etj.

Ndonëse sinonimia është e dëmshme për terminologjinë, kjo gjë nuk i humbet vlerat e kësaj vepre. Autori na paraqitet edhe si njohës i mirë i strukturës gramatikore të shqipes. Me interes do të ishte vështrimi i kësaj

vepre nga pikëpamja e fjalëformimit (termformimit), pra në rrafshin e ndërtimit të termave, ku spikatin në mënyrë të veçantë lidhja midis formës dhe përmbajtjes. Kjo i shton më shumë vlerat punimit.

Autori i ka shfrytëzuar dhe përdorur mirë mënyrat e fjalëformimit (ose të termformimit) të shqipes. Le të sjellim disa shembuj (siç janë përdorur në vepër):

I. MBIEMRA

a) emër + uar/ur/or-e: *thimth* – i *thimthuar*; *valë* – i, e *valëzuar*; *fashikull* – i *fashikulluar* (renditje lulesh afër njëra tjetrës që kanë pak a shumë të njëjtin drejtim dhe lartësi); *kanal* – i *kanaluar* (kërcell i pajisur me kanale); *luspë* – e *luspuar*; *gisht* – e *gishtuar*; *degë* – i *degëzuar*; *vrigull* – e *vrigulluar*; *dhëmb* – e *dhëmbëzuar*; *pupël* – e *pupluar*; *rrudhë* – e *rrudhur*; *cung* – i *cunguar*; *rreth* – *rrethore*; *verë* – (bisqe) *verorë*; *veshkë* – *veshkore*; *halë* – *halore*; *gjethe* – *gjethore*; *tjegull* – *tjegullore*; *mëllugë* – (njolla) *mëllugore*; *stipulë* – *stipulore*; *barishte* – *barishtore*; *anë* – *anësore*; *lëvore* – (gjemb) *lëvoror*; *pykë* – *pykëlore* etj.

b) emër + (t)ake

lesh – *leshatake*; *heshtë* – *heshtake* etj.

c) emër + të ose folje + të

lëkurë – i, e *lëkurtë*; *rrafsh* – i *rrafshhtë*; *mish* – i *mishtë*; *mpreh* – i *mprehtë*;

d) folje + ur/er/ar

përdredh – i *përdredhur*; *shtyp* – i *shtypur*; *drejtoj* – (kërcell) i *drejtuar*; *zgjat* – i *zgjatur*; *mbyll* – (dejësi) e *mbyllur*; *lako* – e *lakuar*; *lëmoj* – i *lëmuar*; *këmbej* – (gjethe) e *këmbyer* etj.

II. Kompozita

linearoheshtake; *thanëqere*, (trëndafil) *qimebutë*, *gjethengjitës*, *lulevogël*; *shkopkuqe*; *shkozëbardhë*; *shkozëlarme*; *shkozëgomare*; (mënishte) *fletësherebelë*; *drizëkuqe*; *bungëkeqe* etj.

III. Varg fjalëformimi *degë* – *degëzim* – *degëzoj* etj.

IV. Të tjera

piramidë – *piramidal-e*; *bulb* – *bulboz*; *kon* – *konik-e*; *ornament* – *ornamental-e* etj.

Në këtë rast mund të themi se termformimet e tij janë me shumë interes për gjuhën e specializuar dhe se ai i përdor me sukses këto modele fjalëformuese të shqipes.

Autori shoqëron çdo dru dhe shkurre me emrat korrespondues në gjuhë të huaja, si rusisht, frëngjisht, gjermanisht, anglisht dhe italisht, natyrshëm

dhe latinisht, “me qëllim që t’u vihet në ndihmë personave që merren me përkthime ose atyre që dëshirojnë të dinë emrat e drurëve dhe shkurreve në këto gjuhë”. Kjo punë kolosale nuk u shërben vetëm përkthyesve, por edhe studentëve të cilët kanë lëndë të detyrueshme gjuhën angleze. Më poshtë po sjellim disa shembuj:

familja e tiseve – *taxacea*; llojet e tiseve: *taxus baccata* (Europë), *taxus cuspidata* (Kinë, Japoni), *taxus canadensis*, *taxus floridana*, *taxus brevifolia* (Amerika e Veriut); **rusisht**: *tisa jagodnij*; **frëngjisht**: *if*; **gjermanisht**: *Eibe*; **anglisht**: *common yew*; **italisht**: *tasso*; ose **bredh i bardhë** – **latinisht**: *abies alba mill*; **rusisht**: *pihta bjellaja*; **frëngjisht**: *sapin*; **gjermanisht**: *Tanne*; **anglisht**: *silver-fir*; **italisht**: *abete bianco* etj.

Gjithashtu ai u dallua për përqasjet e përkthimit (shqipërimet) e tij të sakta të termave të fushës së pylltarisë, të cilat përdoren ende në ditët tona, p.sh: *aksiale* – *sqetulllore*; *bazale* – *themelore*; *internodia* – *ndërrnyjë*; *infloreshenca* – *lulerenditja*; *orbikular* – *i rrumbullakët*; *ornamental-e* – *zbukurues-e*; *filotaksia* – *rreshtimi i gjetheve*; *palmiforme* – *e gishtuar*; *orbikulare* – *rrethore*; *obtuze* – *e topitur*; *koni* – *boçja*, *palmiforme* – *e gishtuar* etj.

Në të gjitha gjuhët e botës dhe në ato me shkallë të lartë përpunimi ekzistojnë **huazime**, kjo për arsye të ndryshme. Në këtë kontekst, nëse i hedhim një sy korpusit të fjalës të përdorur në këtë vepër, do të kuptojmë se tek-tuk janë përdorur disa huazime, si *angjiospermet*, *gjimnospermet*, *aksiale* etj. Ka raste kur krahas termit shqip përdoret termi i huaj, si: *lenticela* – *thierza*; *e gishtuar* – *palmiforme*; *kurorë* – *korolë*; *(syth) mbarues* – *terminal*; *(sythe) laterale* – *anësorë* etj.

Duke paraqitur përhapjen gjeografike të drurëve, shkurreve, klimën tokën që ato kërkojnë, mendojmë se kjo vepër u shërben edhe specialistëve që merren me bujqësinë, turizmin, përpunimin e drurit, krahas atyre të pyjeve.

Fjalorthi i termave të botanikës që shoqëron këtë vepër është dhënë në mënyrë alfabetike. Duke qenë i pari në fushën e pylltarisë, ka shumë vlera, sepse termat shoqërohen me përkufizimet përkatëse, gjë që sjell lehtësi në të kuptuarin, qartësinë e këtyre termave.

Në fund të veprës autori ka krijuar një skedë termash të bimësisë pyjore që gjen përdorim ende sot.

Kjo punë e admirueshme e këtij autori ka sjellë plotësimin e terminologjisë së pylltarisë, si edhe ka shërbyer si bazë dhe gur themeli për botime të tjera në dekadat e mëvonshme

4. Përfundime

- Është një botim i një përmase monumentale për terminologjinë e pylltarisë.
- Kjo vepër ka vlerë sepse tregon pasurinë e gjuhës shqipe, që me potencialet e saj plotëson më së miri nevojat e terminologjisë në tërësi dhe asaj të pylltarisë në veçanti. Nga dialektet e shqipes duhen mbledhur e futur në përdorim fjalë që jo vetëm plotësojnë nevojat e terminologjisë, por dhe që sjellin një pasurim të vërtetë të terminologjisë standarde.
- Termat e përfshirë në këtë vepër kanë fituar qëndrueshmëri dhe kanë gjetur përdorim më gjuhën e specializuar të përdorur midis specialistëve të pylltarisë, tekste, fjalorë, artikuj, studime shkencore.
- Është vepër e një pune të palodhur, mbledhëse, vjelëse, e drejtpërdrejt në terren e autorit, një pasuri kombëtare, ku autori paraqitet një njohës i mirë jo vetëm i shqipes, por edhe i shumë gjuhëve të huaja, gjë që pasqyrohet në përjasjet e termave të pylltarisë me këto gjuhë.
- Referuar terminologjisë së përdorur mund të theksohet se dominon fjala shqipe, gurra popullore.
- Në leksikun e kësaj vepre evidentohen mjetet dhe mënyrat e fjalëformimit të shqipes, të cilat janë përdorur me mjeshtëri nga autori.
- Mitrushi është dhe mbetet një ndër figurat më të mëdha të pylltarisë shqiptare dhe të terminologjisë së saj.

Zhvillimi i vazhdueshëm i fushës së pylltarisë, futja e nocioneve të reja kërkon dhe futjen e përdorimit të termave të rinj. Ndaj duhet vazhduar puna për vjeljen e fjalëve nga goja e popullit, si një nga burimet e terminologjisë krahas të tjerëve, duke marrë atë që është e dobishme për terminologjinë në tërësi dhe në këtë rast të fushës në fjalë në veçanti, dhe duke u dhënë atyre statusin e termave, nëse ato përputhen plotësisht me konceptet e tyre përkatëse. Kjo do të plotësonte nevojat e kësaj fushe, në mënyrë që të shmangen huazimet atje ku është e mundur.

Kjo vepër zbulon gjendjen e leksikut të terminologjisë së pylltarisë në atë kohë, kur ende nuk ekzistonte një fjalor i mirëfilltë terminologjik për fushën e pylltarisë. Nisur nga kontributi i çmuar dhe largpamës i Prof. Mitrushit dhe veprës së tij të vyer, do të ishte e udhës që kjo punë të thellohej më tej nga specialistët e pylltarisë, që ende sot nuk kanë një fjalor të kësaj fushe.

BIBLIOGRAFI

- Bazaj, I., *Leksiku apelativ e onomastik në makro e mikrostrukturën e fjalorëve shpjegues e dygjuhësh të shqipes*, Doktoraturë, Tiranë, 2014.
- Domi, M., “Studime filologjike”, nr. 2/1986.
- J. Thomai “Leksikologjia e gjuhës shqipe”, botimi i tretë, Tiranë, 2005.
- Kostallari, A., *Vëzhgime mbi disa grupe fjalësh popullore të trojeve verilindore të shqipes*, në “Studime mbi leksikun”, III, Tiranë, 1989.
- Mine, L., Disertacion “Leksiku terminologjik i pylltarisë në përqasje me gjuhën angleze” Tiranë, 2013.
- Mitrushi, I., *Drurët dhe shkurret e Shqipërisë*, Tiranë, 1955.
- Mitrushi, I., Karaduni, S., Haska, H., *Frytet dhe farat e drurëve dhe shkurreve të Shqipërisë*, monografi, Tiranë, 2005.
- Osja, A., Fierza, Gj., *Ilia Mitrushi, studiuesi pionier i botanikës shqiptare*, Forumi Shqiptar 16 korrik 2004 <http://www.forumishqiptar.com>
- Thomai, J., *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.